

Tax Alert

January 2022

PwC Albania - Tax Alert

For an addition in law no. 9920, dated 19.5.2008, "For tax procedures in the Republic of Albania", amended

In law no. 9920, dated 19.5.2008, "On tax procedures in the Republic of Albania", amended, in Chapter XV "Transitional and final provisions", after point 7, of article **"Transitional provisions"**, point 8 is added, with the content:

8. Except as predicted by this law, the implementation of sanctions for administrative offenses related to the effective exercise of law no. 87/2019, "On the invoice and turnover monitoring system", amended, will start to apply after 20.6.2022, for taxpayers, as below:

1. Registered taxpayers with the tax liability of simplified tax on profit for the small business, and who are not VAT registered, and carry out only cash sales towards final consumers, non-taxable persons;
2. Taxpayers who provide water supply to final consumers, as well as the regulated electricity market;
3. Banks or financial institutions for the notification of payments of e-invoices issued by taxpayer entities."

Source : [Link](#)

For some changes and additions to law no. 90/2019, "On the revaluation of real estate", as amended

Article 1 is amended as follows:

1. All individuals who own real estate, have the right, from the date of entry into force of this law, until **April 30, 2022** to re-evaluate this property at market value.

2. After point 1, point 1.1 is added, with the following content: "1.1 The provision of point 1, of this article, also applies to claims submitted to the ACA, which have not been completed by April 30, 2022, in case the payment of tax for them is made before July 31, 2022."

In Article 5 the amendment stipulates that this law extends its effects until April 30, 2022.

Source: [Link](#)

Për një shtesë në ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar

Në ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, në kreun XV "Dispozita tranzitore dhe të fundit", pas pikës 7, të nenit **"Dispozita kalimtare"**, shtohet pika 8, me këtë përmbajtje:

8. Përfshirë parashikimeve në këtë ligj, zbatimi i sanksioneve për kundërvajtjet administrative që lidhen me zbatimin efektiv të ligjit nr. 87/2019, "Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit", të ndryshuar, do të fillojë të aplikohet pas datës 30.6.2022, për tatimpaguesit, si më poshtë:

1. Tatimpaguesit e regjistruar me përgjegjësinë tatimore të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël dhe që nuk janë të regjistruar për TVSH-në, të cilët kryejnë vetëm shitje me para në dorë kundrejt konsumatorëve finalë, persona të patatueshëm;
2. Tatimpaguesit që ofrojnë furnizimin me ujë për konsumatorët finalë, si dhe tregu i rregulluar i energjisë elektrike;
3. Bankat apo institucionet financiare për njoftimin e pagesave të e-Faturave të lëshuara nga subjektet tatimpaguese."

Burimi: [Link](#)

Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 90/2019, "Për rivlerësimin e pasurisë së paluajtshme", të ndryshuar

Në nenin 1 bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

1. Të gjithë individët, të cilët kanë në pronësi pasuri të paluajtshme, kanë të drejtë që, nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, deri në datën **30 prill 2022** të bëjnë rivlerësimin e kësaj pasurie me vlerën e tregut.

2. Pas pikës 1 shtohet pika 1.1, me këtë përmbajtje: "1.1 Parashikimi i pikës 1, të këtij neni, zbatohet edhe për kërkesat e dorëzuara pranë ASHK-së, të cilat nuk kanë përfunduar brenda datës 30 prill 2022, në rast se pagesa e tatimit për to bëhet para datës 31 korrik 2022."

Në nenin 5 ndryshimi percakton se ky ligj i shtrin efektet deri në datën 30 prill 2022.

Burimi: [Link](#)

PwC Albania - Tax Alert

For some changes in instruction no. 16, dated 3.4.2020, “For the invoice and turnover monitoring system”

In Article 5 “Taxpayers, who are excluded from the obligation to release an invoice”, letter “b”, of point 1, changes in content as follows:

b) taxpayers that provide taxi services equipped with a taximeter and those who sell tickets or travelcards for the transport of passengers in the public transport sector within the city (buses) if the invoice of the taximeter, ticket or travelcard is given to passengers directly by the driver of the vehicle or by an authorized person.”

In Article 20 “Registration of invoices in the sale and purchase books”, last paragraph of point 11, changes in content;

“Invoices fiscalized by entities that exercise their activity in the telecommunications, insurance, electricity and water supply field for final consumers, as well as monthly invoices related to long-term leasing contracts and similar invoices, which are issued continuously and on the basis of a long-term contract agreed on in advance by the involved parties, are to be considered automatically fiscalised and despite the status of the buyer. In order to record invoices as per above in the purchase books, all taxpayers “buyers” have to ensure that their data in the contract on which the supply is based, is updated/specified ”.

Source: [Link](#)

Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 16, datë 3.4.2020, “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit”

Në nenin 5 “Tatimpaguesit që përjashtohen nga detyrimi për të lëshuar faturë”, germa “b”, e pikës 1, ndryshon me përmbajtje si ne vijim:

b) tatimpaguesit që ofrojnë shërbimin taksi të pajisur me taksimetër dhe ata që shesin bileta ose abone për transport pasagjerësh në sektorin e transportit publik urban brenda qytetit (autobusë) nëse fatura e taksimetrit, bileta ose aboneja u jepet pasagjerëve direkt nga drejtuesi i mjetit ose nga një person i autorizuar;”.

Në nenin 20 “Regjistrimi i faturave në librin e shitjes dhe librin e blerjes”, paragrafi i fundit i pikës 11, ndryshon me përmbajtje;

“Faturat e fiskalizuara nga subjekte që ushtrojnë aktivitet në fushën e telekomunikacionit, sigurimeve, furnizimit të energjisë elektrike dhe ujit për konsumatorët finalë, si dhe faturat mujore të lidhura me kontrata afatgjata leasing dhe fatura të ngjashme me to, të cilat lëshohen në mënyrë të vazhdueshme dhe mbi bazën e një kontrate afatgjatë të lidhur paraprakisht nga palët, do të çmohen të fiskalizuara automatikisht dhe pavarësisht statusit të blerësit. Me qëllim regjistrimin e faturave si më sipër në librat e blerjes, të gjithë tatimpaguesit blerës duhet të sigurohen për të përditësuar/saktësuar të dhënat e tyre në kontratën mbi të cilën bazohet furnizimi.”.

Burimi: [Link](#)



Let's talk!

For further information, please contact:

PricewaterhouseCoopers Albania
Str. "Ibrahim Rugova", Sky Tower, 9/1

Telephone: +355 4 22 90 700

Email: al_pwc_albania@pwc.com

Web: www.pwc.com/al

